



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.1/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses NPSH “V.” tani Fabrika e tepihëve N. T. SHPK me seli në ..., Sheshi i Lirisë në I., të cilën e përfaqëson avokat Ekrem Smajli nga P., kundër të paditurës Komuna e Istogut, për shkak të lirimit të patundshmërisë, kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur, duke vendosur në konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë, për të vendosur në këtë çështje juridike, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 9 shkurt 2023, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, caktohet me kompetencë lëndore Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, të cilës shkresat e lëndës t'i përcillen për procedim të mëtejshëm.

### A r s y e t i m i

Paditësja më datën 19 shtator 2012, në Gjykatën Komunale në Istog ka paraqitur padi kundër të paditurës për lirimin e patundshmërisë, më saktësisht lirimin e katër ngastrave kadastrale të përshkruara në arsyetimin dhe petitumin e kësaj padie, duke kërkuar edhe kompensimin real tokë për tokë dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar si dhe fitimit të humbur.

Gjykata Komunale në Pejë – Dega në Istog, jashtë seance më datën 19 gusht 2022, me aktvendimin C.nr.487/20 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së sipër përmendur të paditëses kundër të paditurës, dhe ka vendosur që lënda t'i dërgohet në kompetencë lëndore Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin KP.nr.141/22 datë 4 janar 2023 hapë konfliktin e kompetencës midis të njëjtës gjykatë dhe Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, duke kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës, të vendos konfliktin e kompetencës midis këtyre dy gjykatave të ndryshme, ashtu që Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Istog ta caktoj si gjykatë me kompetencë lëndore për të gjykuar lidhur me padinë e lartpërmendur të paditëses kundër të paditurës.

Meqë ky konflikt kompetence është hapur midis gjykatave të llojit të ndryshëm, në kuptim të nenit 25.2 të LPK-së, këtë konflikt kompetence e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje konkrete juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog për këto arsye:

Në nenin 12 par. 1 të Ligjit për gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që *gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me Ligj parashihet ndryshe.*

Ndërsa, me nenin 13.1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-015, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 7, datë 10 shkurt 2022, parashihet që *Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në dhomat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kontestet ndërmjet shoqërive tregtare, vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë, publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera në mes tyre, ndërsa në nën pikën 7 të nenit 13.1 të këtij Ligji, parashihet e njëjta kompetencë e Gjykatës Komerciale për kontestet në mes të shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është paraparë me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe Ligjin për shoqëritë tregtare, e po ashtu, me nënpikën 6 të këtij neni edhe për kontestet që lidhen me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare.*

Nga analizimi me kujdes i këtyre dispozitave ligjore për kompetencën e gjykatave të sipër përmendura, rezulton se strumbullari i kompetencës së Gjykatës Komerciale ndërmjet shoqërive tregtare, vendore dhe të huaja si dhe në kontestet ndërmjet personave juridikë, publikë dhe privat është afarizmi reciprok tregtar në mes tyre por edhe të drejtat tjera sendore në mes tyre të cilat mund të jenë objekt i këtij kontesti. Mirëpo, në rastin konkret Komuna e Istogut nuk është shoqëri tregtare e as person juridik privat kështu që duke marrë parasysh

edhe objektin e kontestit që është lirimi i patundshmërisë e jo afarizmi tregtar në mes tyre dhe faktin se në kuptim të nenit 41 të LPK-së, kompetenca ekskluzive për zgjidhjen e këtyre kontesteve është e gjykatës në territorin e të cilës ndodhen patundshmëritë kontestuese, e të cilat janë në territorin e Komunës së Istogut, pa asnjë dyshim rezulton se për të gjykuar në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore duhet të jetë Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog.

Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartpërmendura ligjore, në bazë të nenit 25.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CN.nr.1/2023 datë 9 shkurt 2023

Kryetari i kolegjit

Shukri Sylejmani